



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:041767

Datë: 14.08.2018

Numri i dokumentit: 00104525

P.nr.997/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin e vetme gjykuese, Hakile Ilazi si dhe procesmbajtësen Ganimete Avdiu, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurit A.H nga Fshati....., Komuna Ferizaj, për shkak se ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1367-5/18 dt.23.07.2018, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 08.08.2018, në praninë e Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, si dhe të akuzuarit A.H, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, me datë 08.08.2018, ndërsa më dt.14.08.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: A.H i lindur me..., nga i ati.....dhe nëna.... e gjinisë....., me vendbanim në Fshatin..., Komuna Ferizaj, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në “E. M”, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal....

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me dt.02.07.2018, në fshatin Koshare, Komuna Ferizaj, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete në mënyrë të kundërligjshme, ka mashtruar të dëmtuarin I.H duke e vënë në lajthim në atë mënyrë që i kishte kërkuar, që t'ia shesë një lopë së bashku me viç, në shumën prej 1500€, duke bërë marrëveshje që 750 € t'ia jep pas tre ditëve kurse shumën tjetër prej 750€ me dt. 01.08.2018 ku nga ajo ditë asnjëherë më nuk ishte lajmëruar të dëmtuarit, si dhe në të njëjtën ditë lopën me gjithë viç e kishte shitur në Fshatin Gllgovcë, Komuna Lipjan, në shumën prej 1.000€ duke i shkaktuar dëme të dëmtuarit I.H në shumë prej 1500€.

me këtë ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,21,41,42, 43,45,46,73,74,75,76 dhe nenit 335 par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

Të akuzuarin A.H, dënim me burgim në kohë prej 3/tre/ muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, po ashtu obligohet ta paguaj edhe gjobën brenda afatit prej 1(një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

Në dënimin e shqiptuar si më lartë i llogaritet edhe koha e kaluar nën arrest shtëpiak nga data 09.07.2018 deri më 08.08.2018.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin brenda afatit prej 1 (një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzetë euro), të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari A.H që të dëmtuarit I.B nga fshati.... Komuna Ferizaj në emër të kërkesës pasurore juridike t'i kompensoj shumën në vlerë prej 1500/njëmijë e pesëqindtë euro/€, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 €uro /njëzet e pesë/ në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajnë shumën prej 30 €uro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.1367-5/18 dt.23.07.2018 ka ngarkuar të akuzuarin A.H, se ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPRK-së, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 08.08.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, duke shpreh keqardhje dhe është i penduar thellë, i njëjti shton se është hera e parë që bie ndesh me ligjin për vepra të tilla penale, dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë.*

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurve, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të iu shqipton dënimin e merituar.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar për të gjitha pikat ne aktakuza, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, faktet e provuara të çështjes që i përmban aktakuza edhe atë: Deklarata e të dëmtuarit dhe deklarata e të pandehurit si dhe shkresat e lëndës.
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është i njohur më parë si kryes i veprave penale, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal,
P.nr.997/18 datë 14.08.2018.

Zyrtare ligjore,

Gjyqtarja,

Hakile Ilazi

Ganimete Avdiu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.